UNIVERSITETI I PRISHTINES
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush Ndërtesë e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektoratl@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 152
Date: 25/01/2023

RAPORTI I VLERËSIMIT PËR DORËSHKRIMIN E PUNIMIT TË DIPLOMËS SË MASTER-it

Fakulteti	**i Inxhinierisë Mekanike**
Departamenti/Programi	**Komunikacionit/Komunikacion rrugor**
Projektpropozimi	*Analiza e kohës së punës, pushimit të personelit që kryejnë transport rrugor ndërkombëtar përmes pajisjeve regjistruese të tahografit në funksion të organizimit të procesit teknologjik të transportit të udhëtarëve në një ndërrmarrje transportuese*
Kandidati	**Bastri Sallahu**
Mentori	**Prof.Ass.dr. Ramadan Duraku**
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e fakultetit	Datë: 28/05/2021
	Vendimi me nr.: Vendimi 679/2-11, Datë: 28/05/2021

Vlerësimi i dorëshkrimit:

Në bazë të vendimit të Dekanit të Fakultetit, nr. 679/2-11 të datës: 28/05/2021 është formuar komisioni me këtë përbërje:

1. Prof.dr.sc. Arbnor Pajaziti, kryetar,
2. Prof.Ass.dr. Ramadan Duraku, mentor.
3. Prof.dr.sc.Naser Lajqi, anëtar.

për vlerësimin e punimit Master me titull ***"Analiza e kohës së punës, pushimit të personelit që kryejnë transport rrugor ndërkombëtar përmes pajisjeve regjistruese të tahografit në funksion të organizimit të procesit teknologjik të transportit të udhëtarëve në një ndërrmarrje transportuese"*** (*Analysis of working time, rest of personnel who perform international road transport through tachograph recording devices in function of the organization of the technological process of passenger transport in a transport operator*), të kandidatit Ing.dipl.Bastri Sallahu.

Pas kontrollimit të punimit të lartpërmendur Komisioni jep këtë:

RAPORT

Punimi me titull ***"Analiza e kohës së punës, pushimit të personelit që kryejnë transport rrugor ndërkombëtar përmes pajisjeve regjistruese të tahografit në funksion të organizimit të procesit teknologjik të transportit të udhëtarëve në një ndërrmarrje transportuese"*** (*Analysis of working time, rest of personnel who perform international road transport through tachograph recording devices in function of the organization of the technological process of passenger transport in a transport operator*), është hartuar në 8 kapituj dhe është ilustruar përmes 120 figurave, 2 grafikoneve dhe 10 tabelave.

Në kapitullin **e parë** si hyrje janë dhënë sqarimet lidhur me konceptin e tahografit dhe roli i tij në trafikun rrugor. Mandej është dhënë në pika të shkurtra historiati i përdorimit dhe arsyet e aplikimit të tahografit. Mandej është vazhduar me sqarimin lidhur me rregullativën që mbulon fushën e tahografit në nivelin nacional edhe atë ndërkombëtar, sidomos me kategoritë e automjeteve të transportit rrugor që kanë të obliguar instalimin e pajisjes s ëtahografit. Aplikimi i rregulloreve të reja metrologjike për tahografët, d.m.th. rregulla për kushtet metrologjike për pajisjet monitoruese për kontrollin e punës së shoferit dhe lëvizjen e automjeteve në trafikun rrugor dhe udhëzimet metrologjike për inspektimin e pajisjeve të monitorimit për kontrollin e punës së shoferit dhe lëvizjen e automjeteve në trafikun rrugor.

Në **kapitullin e dytë** janë dhënë njohurit lidhur me legjislacionin dhe obligimet lidhur me kohën e ngasjes dhe pushimit të personave në transportitn rrugor ndërkombëtar. Pastaj në mënyrë të detajuar është elaboruar mënyra e organizimit të punës dhe pushimit të punës së personelit (ekuipazheve) të automjeteve që punojnë në transportin rrugor kur ekuipazhi përbëhet nga dy ose më shumë shoferë për periudhën 24 orëshe, një javore, dyjavore dhe në interavlin prej 28 ditëve. Në fund janë dhënë edhe obligimet që kanë operatorët e transportit të licencuar lidhur me respektimin e kritereve dhe kufizimeve të përcaktuar sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar.

Në kapitullin **e tretë** është dhënë përshkrimi lidhur me ndarjen dhe klasifikimi i mjeteve transportuese që kanë të obliguar instalimin e pajisjes së tahograf-it dhe kufizuesve të shpejtësisë. Në fillim janë dhënë sqarimet e nevojshme për automjetet që e kanë për detyrim instalimin e apartit të kontrollit- tahografin, duke vazhduar pastaj me automjetet e transportit rrugor që janë të liruara nga ky detyrim. Poashtu janë dhënë sqarimet e nevojshme se cilat automjete kanë të obliguar instalimin e kufizuesit të shpejtësisë dhe cilat automjete janë të liruara.

Në kapitullin **e katër** është dhënë fillimisht funksioni i tahografit dhe aplikimi i tij. Mandej është dhënë ndarja dhe klasifikimi i tyre sipas kritereve te ndryshme, sipas: qëllimit, transmetimit të impulsit, formati i mediumit të regjistrimit, dhe kohëzgjatja e periudhave të regjistrimit. Janë dhënë sqarimet e nevojshme lidhur me incizimin e katër aktiviteteve që mund të evidentohen në tahografin analog,sikurse janë: koha efektive e drejtimit ("ngasja"), koha tjetër e funksionimit ("çekiç"), koha e disponueshmërisë ("kub"), pauzat gjatë ngasjes (vozitjes) dhe koha e pushimit ditor ("krevat"). Poashtu është dhënë edhe klasifikimi i tahografëve dixhital prej gjeneratës së parë e deri tek "smart" tahografët.

Në kapitullin e **pestë** është dhënë metodologjia e grumbullimit, përpunimit të dhënave të regjistruara përmes tahografit. Pastaj janë dhënë mënyrat e regjistrimit dhe evidentimit të shënimeve në fletëzat për tahografët analog dhe 'kartat" për tahogrfët dixhital. Poashtu janë dhënë elementet e plotësimit nga ane personelit të shënimeve në tahografin analog. Kurse për tahografin dixhital është dhënë mënyra e regjistrimit dhe evidentimit të shënimeve si dhe prezentimit para organeve të kontrollit. Këtu janë dhënë sqarime më të detajuara lidhur me kartat e ndryshme të tahografit dixhital, sikurse janë: karta e shoferit, karta e operatorit transportues, karta e puntorisë (servisit) dhe karta e organit mbykqyrës. Në mënyrë të përmbledhur në mënyrë tabelare është sqarimi lidhur me të drejtën e qasjes (akcesit) në të dhëna.

Në kapitullin **e gjashtë** është folur fillimishtë për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar. Pastaj është vazhduar me sqarimet e nevojshme lidhur me dokumentaconin e udhëtimit për ndërmarrjen transportuese që operon në linjën ndërkombëtare të udhëtarëve me autobus. Pra është dhënë një pasqyrë e dokumentacionit që është i nevojshëm për një ndërmarrje transportuese vendore për operim në transportin e rregullt ndërkombëtar të udhëtarëve. Dokumentacioni është i ndarë në tri kategori, sikurse janë: dokumentacioni për ndërrmarrjen transportuese, dokumentacioni për shoferin dhe dokumentacioni për automjetin. Për secilën prej këtyre kategorive janë dhënë sqarimet e nevojshme si dhe bazën ligjore të tyre.

Në kapitullin e **shtatë** është dhënë analiza dhe interpretimi i rezultateve të dhënave të regjistruara përmes tahografit në menaxhimin e personelit dhe autoparkut të një ndërmarrje transportuese. Fillimishtë janë dhënë shënimet lidhur me autoparkun, personelin dhe veprimtarinë e ndërrmarjes transportuese. Këtu janë sqaruar mënyrat dhe mundësitë e leximit të shenimeve nga fletëzat e tahografit analog dhe nga kartat e tahografit dixhital. Në këtë kapitull fokusi ka qenë i orientuar në analizimin e aktiviteteve të shoferëve që punojnë në linjën e rregullt ndërkombëtare mbi 500 km, respektivishtë aktivitetet që ka kry një shofer gjatë periudhës kohore 01.08.2021 deri 31.08.2020. Në bazë të të dhënave të mbledhura, janë formuar raporte në formë të dixitalizuar, të cilat pastaj janë ruajtur në kompjuter. Secili raport është analizuar në mënyrë të detajuar, sipas kohës së punës (ngasjes), ndërprerjeve (pauzave) dhe pushimeve jashtë automjetit. Mandej janë ndërtuar grafikonet dhe tabelat përmbledhëse përmes të cilave u bë e mundur kryerja e analizës dhe nxerrja e konkluzioneve lidhur me respektimin e kufizimeve të orarit të punës dhe pushimeve nga e këtij shoferi sipas kufizimeve ligjore vendore dhe marrveshjes AETR.

Në kapitullin **e tetë** janë dhënë përfundimet lidhur me pajisjet tahograf janë pajisje të përcaktuara me ligj që gjenden në çdo mjet transporti rrugor të mallrave dhe udhëtarëve me rolin kryesor të kontrollit të shoferit (drejtuesit) dhe rritjen e sigurisë rrugore. Poashtu është dhënë lidhja e drejtpërdrejtë midis sigurisë dhe aftësisë së shoferëve (drejtuesve) të mjeteve për të kryer në mënyrë efikase dhe të sigurt aktivitete të caktuara (ngasje) ku i inkurajoi ligjvënësit, operatorët transportues dhe punonjësit e tyre të kufizojnë kohëzgjatjen maksimale të lejuar të ngasjes pa ndalur dhe pa bërë pushime, duke rregulluar gjithashtu periudhat e detyrueshme ditore dhe javore të pushimit. si pushime të detyrueshme për drejtuesit e mjeteve, të gjitha me qëllim të përmirësimit të sigurisë në trafikun rrugor, si dhe parandalimin e shtrembërimit të konkurrencës në treg. Në fund janë dhënë dobësit e përdorimit të tahografit analog dhe përparësitë nëse operatori transportues fillon me implementimin e tahografit dixhital në të ardhmen.

PËRFUNDIM

Në bazë të shqyrtimit të punimit Master, Komisioni për vlerësim konsideron se punimi është hartuar në nivel të duhur, i shtjelluar përmes figurave dhe tabelave.

Prandaj, Komisioni për vlerësimin e punimit Master, të kandidatit Ing.dipl.Bastri Sallahu, me titull ***"Analiza e kohës së punës, pushimit të personelit që kryejnë transport rrugor ndërkombëtar përmes pajisjeve regjistruese të tahografit në funksion të organizimit të procesit teknologjik të transportit të udhëtarëve në një ndërrmarrje transportuese"*** *(Analysis of working*

time, rest of personnel who perform international road transport through tachograph recording devices in function of the organization of the technological process of passenger transport in a transport operator), mendon se i plotëson ë gjitha kriteret për punim Master, prandaj i propozon Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, që ta aprovoj si punim për Master dhe ta jep në diskutim publik.

Prishtinë, 24.01.2023 .

Komisioni:

1. _____
(Prof.dr.sc. Arbnor Pajaziti, kryetar)

2. _____
(Prof.Ass.dr.Ramadan Duraku, mentor)

3. _____
(Prof.dr.sc.Naser Lajqi,anëtar)

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I INXHINERISË MEKANIKE

DEPARTAMENTI I KOMUNIKACIONIT

PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

Lënda: Teknologjia e transportit te udhëtarëve në trafikun rrugor

Tema: ***Analiza e kohës së punës, pushimit të personelit që kryejnë transport rrugor ndërkombëtar përmes pajisjeve regjistruese të tahografit në funksion të organizimit të procesit teknologjik të transportit të udhëtarëve në një ndërmarrje transportuese***

Mentori:
Prof.Ass.Dr. Ramadan Duraku

Kandidati:
Bastri Sallahu

Prishtinë, 2023

PËRMBAJTJA

FALËNDERIMI (opsional) 6

LISTA E FIGURAVE..... 7

LISTA E TABELAVE..... 8

1. HYRJE 9

1.1.Tahografi dhe roli i tij në trafikun rrugor 9

1. NJOHURIT LIDHUR ME LEGJISLACIONIN DHE OBLIGIMET LIDHUR ME KOHËN E NGASJES DHE PUSHIMIT TË PERSONAVE NË TRANSPORTITN RRUGOR NDËRKOMBËTAR.....13

2.1 Rregullore mbi tahografët dhe kufizimet e shpejtësisë nga aspekti i teknikëve në punim për tahografët.....13

2.2 Orët e punës së personelit që i drejtojnë mjetet transportuese në kuadër të operatorit transportues 15

2.2.1. Legjislacioni dhe orari i punës së personelit (ekuipazheve) të automjeteve.....**Error! Bookmark not defined.**

2.2.2. Menaxhimi i kohës së punës së ekuipazhit .....**Error! Bookmark not defined.**

2.2.3. Detyrimet e operatorëve transportues 24

3. NDARJA DHE KLASIFIKIMI I AUTOMJETEVE QË E KANË TË OBLIGUAR INSTALIMIN E PAJISJES SË TAHOGRAF-it 25

3.1. Automjetet 25

3.1.1. Automjetet që e kanë për detyrim instalimin e aparatit të kontrollit-tahografin 25

3.1.2. Përjashtimet nga detyrimi që e kanë për detyrim instalimin e aparatit të kontrollit-tahografin 26

3.1.3. Automjetet që e kanë për detyrim të kenë të instaluar kufizuesin e shpejtësisë 28

3.1.4. Përjashtimet nga detyrimi për instalimin e kufizuesit të shpejtësisë 30

4. FUNKSIONI I TAHOGRAFIT DHE APLIKIMI 32

4.1. Tahografi .....**Error! Bookmark not defined.**

4.2. Aspektet e funksionimit të tahografit 33

4.3. Ndarja dhe klasifikimi i tahografëve 36

4.4. Regjistrimet e evidentuara nga tahografi 41

4.5. Detyrat e aplikimit të tahografit në trafikun rrugor 46

5. GRUMBULLIMI, PËRPUNIMI I TË DHËNAVE TË REGJISTRUARA PËRMES TAHOGRAFIT .....**Error! Bookmark not defined.**

5.1. Tahografi analog .....**Error! Bookmark not defined.**

5.2. Tahografi dixhital 51

5.3. Të drejtat e qasjes (akcesit) në të dhëna 64

5.4. Mbikqyrja e respektimit të ligjit për orarin e punës së shofereve dhe puntorëve mobil në kuader të operatorit transportues 66

6. DOKUMENTACIONI I UDHËTIMIT PËR NDERRMARRJEN TRANSPORTUESE QË OPERON NË LINJËN NDËRKOMBËTARE TË UDHËTAREVE ME AUTOBUS 68

6.1. Hyrje 68

6.2. Dokumentacioni për ndërmarrjen transportuese 70

6.3. Dokumentacioni për automjetin 84

6.2. Dokumentacioni për shoferin 97

7. ANALIZA DHE INTERPRETIMI I REZULTATEVE TË DHËNAVE TË REGJISTRUARA PËRMES TAHOGRAFIT NË MENAXHIMIN E PERSONELIT DHE AUTOPARKUT TË NJË NDËRMARRJE TRANSPORTUESE 98

7.1. Procedura e leximit të veprimtarive të punës nga fletët e regjistrimit.....101

7.2. Procedura e leximit të aktiviteteve të punës nga kartat dixhitale.....102

7.3. Analiza e të dhënave të lexuara dhe monitorimi i performancës së shoferit.....105

7.4. Përmbledhja e aktiviteteve të shoferit për muajin Gusht 2021.....138

7.5. Analiza e aktiviteteve të shoferit të relizaura përgjatë muajit Gusht 2021.....138

8. PËRFUNDIMI 142

LITERATURA 145

FALËNDERIMI

Dua të falënderoj së pari ZOTIN që më dha shëndetin dhe vullnetin për të punuar, gjithashtu dua të falënderoj dhe familjen time për përkrahjen e vazhdueshme dhe gjithashtu shoqërinë time.

Poashtu një falënderim i veçantë për mentorin e punimit të diplomës Prof. Ass.dr. Ramadan Duraku, për përkrahjen e vazhdueshme lidhur me finalizimin e punimit të diplomës.

Gjithashtu dua të falënderoj dhe anëtarët e komisionit Prof.Dr.Arbnor Pajziti -kryetar dhe Prof.dr.Naser Lajqi- antarë për këshillat dhe sugjerimet që ky punim i diplomës të marr përmbajtjen e merituar.

LISTA E FIGURAVE

Fig.1.1Forma e një shënimi të tahgrafi të zakonshem 11
Fig.2.1 Kombinimet e lejuara të kohës së vozitjes dhe pauzes.....20
Fig 2.2 Koha e realizimit të pushimit ditor të shoferit në periudhën 24 orëshe.....22
Fig 2.3 Realizimi i pushimit ditor të ekuipazhit me dy shoferë në periudhën 30 orëshe.....22
Fig 2.4 Pushimet javore.....23
Fig.3.1 Komplete automjetesh me rimorkio (llojet M1+O dhe N1+O) MML e të cilave kalon 3,5 t, dhe në të cilat është instaluar një tahograf dhe janë përfshirë në zonën e aplikimit të LTRr.... 26
Fig.3.2 Autobus i specializuar (makinë transfuzioni) dhe një grup automjetesh që përdoren për qëllime mjekësore dhe që janë jashtë objektit të marrëveshjes AETR dhe LTRr 28
Fig 3.3 Mjetet e përdorura për kërkime shkencore në rrugë.....31
Fig.4.1 Tahografi analog i tipit 1324 32
Fig. 4.2 Pjesë dhe funksione dixhitale të tahografit.....33
Fig. 4.3 Ndarja dhe klasifikimi i tahografit..... 36
Fig. 4.4. Tahografët standard EC 1311/1314.....38
Fig. 4.5. Tahografi automatik EC 1319/1324.....38
Fig. 4.6. Prodhuesit dhe etiketat e versioneve të gjeneratës së parë.....39
Fig. 4.7. Tahografi dixhital.....39
Fig 4.7 Fletë tahografi para dhe mbrapa 41
Fig. 4.8. Regjistroni dhe futni manualisht në fletën e tahografit.....42
Fig 4.9. Regjistrimi i shpejtësisë në fletën e tahografit.....43
Fig. 4.10. Regjistrimi i aktiviteteve të ekuipazhit-shoferit.....43
Fig 4.11. Distanca e përshkuar.....44
Fig 4.12. Shfaqja e numrit të rrotullimeve të motorit në pjesën e pasme të flëtës.....44
Fig 5.1 Tahografi analog VDO 1324.....48
Fig 5.2 Të dhënat e regjistruara në pjesën e përparme të fletës së regjistrimit të tahografit analog.....49
Fig 5.3. Të dhënat e regjistruara në pjesën e pasme të fletës së regjistrimit të tahografit analog.....51
Fig 5.4. Fletët e regjistrimit të tahografit analog për ekuipazhe me dy shoferë Tahografi analog VDO 1324.....52
Fig 5.5 Tahografi dixhital.....55
Fig 5.6 Shembull i printimit nga tahografi dixhital.....58
Fig 5.7 Shtypja e shpejtësisë së automjetit nga tahografi dixhital.....59
Fig 5.8 Matrica raster në pjesën e pasme të shiritit të printimit të tahografit dixhital.....59
Fig 5.9 Pjesa e përparme dhe e pasme e kartës së shoferit.....61
Fig.5.10 Pjesa e përparme dhe e pasme e kartës së transportuesit.....62
Fig 5.11 Para dhe mbrapa kartës së punëtorisë.....63
Fig 5.12 Pjesa e përparme dhe e pasme e kartës së kontrollit.....64
Fig 6.1. Zyret e ndërmarrjes transportuese 'Eurolines" sh.p.k në Kosovë dhe Gjermani.....68
Fig 6.2. Certifikata e regjistrimit të biznesit për kompaninë transportuese "ERLINES"sh.p.k...71
Fig 6.3 Numri Unik Identifikues i Biznesit (Faqja 3 nga 8).....72
Fig 6.4 Numri Unik Identifikues i Biznesit (Faqja 4 nga 8).....72
Fig 6.5 Numri Unik Identifikues i Biznesit (Faqja 5 nga 8).....73
Fig 6.6 Numri Unik Identifikues i Biznesit (Faqja 6 nga 8).....73
Fig 6.7 Numri Unik Identifikues i Biznesit (Faqja 7 nga 8).....73

Fig 6.8 Numri Unik Identifikues i Biznesit (Faqja 8 nga 8).....73
Fig 6.9 FletëUrdhëresë e rrugës për autobusin e kompanisë transportuese ERLines-sh.p.k, faqja ballore.....74
Fig 6.10 FletëUrdhëresë e rrugës për autobusin e kompanisë transportuese ERLines-sh.p.k, faqja e pasme.....74
Fig 6.11 Shembull i një rendi të udhëtimit në gjuhën shqipe 75
Fig 6.11 Shembull i një rendi të udhëtimit në gjuhën gjermane 75
Fig 6.13. Çmimorja e udhëtimit për vendstnacione të ndryshme në Gjermani e operatorit ER-Lines SH.P.K për linjën ndërkomëtare Prizren (RKS)- Frakfurt am Main (D).....76
Fig 6.14. Itinerari nga Suhareka (Kosovë) në Frankfurt (Gjermani) i paraqitur me hartë.....76
Fig 6.15 Kontrata e bashkëpunimit për linjën Suhareka (Kosovë) në Frankfurt am Main (Gjermani).....78
Fig 6.16 Plani i udhëtimit të shoferëve në linjën Suharekë-Frankfurt e operatorit ER-Lines SH.P.K. (Faqja 1 nga 2).....79
Fig 6.17 Plani i udhëtimit të shoferëve në linjën Suharekë-Frankfurt e operatorit ER-Lines SH.P.K. (Faqja 2 nga 2).....80
Fig 6.18 Licenca "A" për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor ndërkombëtar të lirë të udhëtarëve me autobus.....81
Fig 6.19. Licenca "B" për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor ndërkombëtar të lirë dhe të rregullt të udhëtarëve me autobus.....81
Fig 6.20. Licenca "C" për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor vendor të lirë dhe të rregullt të udhëtarëve me autobus.....81
Fig 6.21. Licenca "D" për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor vendor dhe ndërkombëtar të lirë dhe të rregullt të udhëtarëve me autobus.....81
Fig 6.22 Certifikata e kompetencës (aftësisë) profesionale (CPC) për menaxherin e kompanise.82
Fig 6.23. Leja për transport të rregullt të udhëtarëve në transportin rrugor jashtë Kosovës.....82
Fig 6.24 Shembull i një bilete elektronike në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus.....83
Fig 6.25 Njëra faqe e një libreze qarkullimi në Kosovë.....84
Fig 6.26 Një policë sigurimi në Kosovë e kompanisë së sigurimeve "ELSIG"..... 85
Fig 6.27 Një autobus që i bëhet kontrollimi teknik i tij.....86
Fig 6.28 Certifikata e autobusit për operatorin "Erlines" SH.P.K..... 86
Fig 6.29 Certifikata e verifikimit/testimit të tahografit analog.....88
Fig 6.30 Ngjitëse e integruar për tahografin analog.....89
Fig 6.31 Patentë shoferi i Kosovës lëshuar për shoferin e angazhuar në linjë.....91
Fig 6.32 CPC certifikata për shofer të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve.....91
Fig 6.33 Letërnjoftimi i Kosovës.....92
Fig 6.34 Pasaporta e Kosovës.....92
Fig 6.35 Certifikata e mjekut për shofer profesionist.....94
Fig 6.36 Vendosja e disqeve të Tahografi analog në autobus.....95
Fig 6.37 Fletëza e tahografit analog.....95
Fig 6.38 Certifikata e aktiviteteve të shoferit të lëshuara nga operatori transportues.....97
Fig 7.1 Autpoarku dhe personeli i kompanisë transportuese 'ERLINES" sh.p.k.....98
Fig 7.2 Autobus dykatësh i kompanisë "ERLINES"-Sh.p.k.....99

Fig 7.3. Shembull i regjistrimit të aktiviteteve të shoferit.....100
Fig 7.4 Lexues i fletëve të regjistrimit VDO.....102
Fig 7.5 Forma e dixhitalizuar e fletës së regjistrimit.....103
Fig7.6 Regjistrimi standard i aktiviteteve të punës në fletën e regjistrimit.....104
Fig 7.7 Lexuesi i kartës së shoferit dhe transferimi i të dhënave në serverin TIS-Web.....105
Fig 7.8. Dëshmia e pushimit nga aktiviteti i ngasjes për datën 01.08.2021 nga ora 07:00 deri më 04.08.2021 në ora 08:00 për shoferin nga ana e operatorit "ERLINES"-sh.p.k.....106
Fig 7.9 Dëshmia e realizimit të ndonjë aktiviteti tjetër përveç aktivitetit të ngasjes për datën 04.08.2021 për shoferin nga ana e operatorit "ERLINES"-sh.pk.....107
Fig 7.10 Dëshmia e pushimit nga aktiviteti i ngasjes për datën 04.08.2021 nga ora 13:00 deri në orën 24:00 për shoferin nga ana e operatorit.....108
Fig 7.11. Dëshmia e hotelit për pushimin e shoferit nga aktiviteti i ngasjes për këtë dite.....109
Fig 7.12 Regjistrimi standard i aktiviteteve të punës në fletën e regjistrimit.....110
Fig 7.13 Fleta e tahografit për datën 05.08.2021.....110
Fig 7.14 Turnet e ngasjes së shoferit.....111
Fig 7.15 Paraqitja grafike e tabelës 7.1.....111
Fig 7.16 Dëshmia e pushimit nga aktiviteti i ngasjes për datën 01.08.2021 nga ora 07:00 deri më 08.04.2021 në ora 08:00 për shoferin nga ana e operatorit "ERLINES"sh.p.k.....112
Fig 7.17 Fleta e tahografit për 07.08.2021 dhe 08.08.2021.....113
Fig 7.18 Turnet e ngasjes së shoferit.....114
Fig 7.19. Paraqitja grafike e tabelës 7.2.....114
Fig 7.20 Dëshmia e pushimit nga aktiviteti i ngasjes për datën 08.08.2021 nga ora 03:40 deri më 14.08.2021 në ora 08:00 për shoferin nga ana e operatorit "ERLINES"sh.p.k.....115
Fig 7.21 Dëshmia e realizimit të ndonjë aktiviteti tjetër përveç aktivitetit të ngasjes nga data 14.08.2021 deri më datën 21.08.2021 për shoferin nga ana e operatorit "ERLINES" -sh.p.k....116
Fig 7.22 Dëshmia e pushimit nga aktiviteti i ngasjes për datën 21.08.2021 nga ora 21:00 deri më 22.08.2021 në ora 07:00 për shoferin nga ana e operatorit "ERLINES"-sh.p.k.....117
Fig 7.23 Dëshmia e realizimit të ndonjë aktiviteti tjetër përveç aktivitetit të ngasjes me datën 22.08.2021 nga ora 07:00 deri në orën 12:00 për shoferin nga ana e operatorit "ERLINES"sh.p.k.....118
Fig 7.24 Dëshmia e pushimit nga aktiviteti i ngasjes për datën 22.08.2021 nga ora 12:00 deri më 23.08.2021 në ora 00:00 për shoferin nga ana e operatorit "ERLINES"-sh.p.k.....119
Fig 7.25 Dëshmia e hotelit për pushimin e shoferit nga aktiviteti i ngasjes për këtë ditë.....120
Fig 7.26 Fleta e tahografit për datën 23.08.2021.....121
Fig 7.27 Turnet e ngasjes së shoferit.....122
Fig 7.28 Paraqitja grafike e tabelës 7.3.....123
Fig 7.29 Fleta e tahografit për datën 24.08.2021.....124
Fig 7.30 Fleta e tahografit për 25.08.2021 dhe 26.08.2021.....125
Fig 7.31 Turnet e ngasjes së shoferit.....126
Fig 7.32 Paraqitja grafike e tabelës 7.4.....127
Fig 7.33 Dëshmia e pushimit nga aktiviteti i ngasjes për datën 26.08.2021 nga ora 03:45 deri më 28.08.2021 në ora 07:00 për shoferin nga ana e operatorit transportues.....128
Fig 7.34 Dëshmia e realizimit të ndonjë aktiviteti tjetër përveç aktivitetit të ngasjes me datën 28.08.2021 nga ora 07:00 deri në orën 12:00 për shoferin nga ana e operatorit "ERLINES"-sh.p.k.....129

Fig 7.35 Dëshmia e pushimit nga aktiviteti i ngasjes për datën 28.08.2021 nga ora 12:00 deri në orën 24:00 për shoferin nga ana e operatorit "ERLINES" sh.p.k.....130
Fig 7.36 Dëshmia e hotelit për pushimin e shoferit nga aktiviteti i ngasjes për këtë ditë.....131
Fig 7.37 Fleta e tahografit për 29.08.2021.....132
Fig 7.38 Turnet e ngasjes së shoferit.....133
Fig 7.39 Paraqitja grafike e tabelës 7.5.....133
Fig 7.40 Dëshmia e pushimit të shoferit për këtë ditë.....134
Fig 7.41 Fleta e tahografit për 30.08.2021 dhe 31.08.2021.....135
Fig 7.42 Turnet e ngasjes së shoferit.....136
Fig 7.43 Paraqitja grafike e tabelës 7.6.....137
Fig 44. Paraqitja grafike e tabelës 7.1, datë: 05.08.2021.....138
Fig 45. Paraqitja grafike e tabelës 7.2, datat: 07.08.2021 – 08.08.2021.....138
Fig 46. Paraqitja grafike e tabelës 7.3, datë: 23.08.2021.....138
Fig 47. Paraqitja grafike e tabelës 7.4, datat: 25.08.2021 – 26.08.2021.....138
Fig 48. Paraqitja grafike e tabelës 7.5, datë: 29.08.2021.....138
Fig 49. Paraqitja grafike e tabelës 7.6, datat: 30.08.2021 – 31.08.2021.....138
Grafiku 1. Orët e ngasjes së shoferit gjatë muajit Gusht të vitit 2021.....139
Grafiku 2. Shuma e orëve të ngasjes për turne të shoferit gjatë muajit Gusht të vitit 2021.....139

LISTA E TABELAVE

Tabela 3. 1. Datat e instalimit të detyrueshëm të kufizuesve të shpejtësisë sipas datës së regjistrimit të parë në përgjithësi (kudo në botë dhe jo vetëm në Republikën e Kosovës).....29
Tabela 3.2. Detyrimi për vendosjen e kufizuesve të shpejtësisë sipas datës së regjistrimit të parë në përgjithësi (në çdo shtet) dhe në Republikën e Kosovëës.....30
Tabela 5.1 E drejta e aksesit dhe llojet e të dhënave në varësi të kartës së futur.....65
Tabela 7.1 Leximi dhe përshkrimi i aktiviteteve nga fleta e tahografit për datën 05.08.2021....111
Tabela 7.2. Leximi dhe përshkrimi i aktiviteteve nga fleta e tahografit për datat 07.08.2021-08.08.2021.....114
Tabela 7.3. Leximi dhe përshkrimi i aktiviteteve nga fleta e tahografit për datën 23.08.2021...123
Tabela 7.4. Leximi dhe përshkrimi i aktiviteteve nga fleta e tahografit për datat 25.08.2021-26.08.2021.....127
Tabela 7.5. Leximi dhe përshkrimi i aktiviteteve nga fleta e tahografit për datën 29.08.2021...133
Tabela 7.6. Leximi dhe përshkrimi i aktiviteteve nga fleta e tahografit për datat 30.08.2021-31.08.2021.....137
Tabela 7.7. Shumat e orëve të ngasjes përgjatë muajit Gusht 2021.....140

Kapitulli

1

1.HYRJE

1.1 Tahografi dhe roli i tij në trafikun rrugor

1.1.1 Koncepti, fillimi dhe zhvillimi historik

Duke u nisur nga rrënja e fjalës tahograf, ajo përbëhet nga fjalët greke **"tachys"** që do të thotë *shpejtësi* dhe **"graf"** që do të thotë *shënim*, arrijmë në kuptimin bazë të termit tahograf: një pajisje që përveç matjes së shpejtësisë, edhe e regjistron atë në të njëjtën kohë.

Filloi të aplikohej në fund të shekullit të XIX-të dhe fillimit të shekullit të XX-të me kërkesë të pronarëve të kompanisë së birrës, të cilët donin të kontrollonin mënyrën e përdorimit të flotës së tyre. Duke pasur parasysh detyrën, një nga tahografët e parë që u përdor u quajt "WAS-WAR-WANN" i cili në përkthimin më të saktë do të thoshte "ÇFARË-ISHTE-KUR", kështu që tahografi dhe aplikimi i tij në trafik u promovua si rezultat i aspiratave të pronarëve të flotës sepse [1]:

- mund të posedojmë njohuri më të sakta mbi racionalitetin e përdorimit të automjeteve të flotës,
- arrihet organizim më i mirë lidhur me punën e automjeteve, dhe
- kemi përfitime ekonomike lidhur me përcjelljen e shpenzimeve.

Duke vëzhguar zhvillimin historik të kësaj pajisjeje, mund të thuhet se kërkesa themelore ka mbetur e njëjtë dhe ndryshimet janë në një masë të madhe, pasojë e zhvillimit teknologjik dhe mundësive që ofroi ai zhvillim.

Në këtë drejtim, tendencat më të theksuara të zhvillimit janë: parandalimi i abuzimit me shoferin dhe rritja e numrit të dhënave të regjistruara në kartën e tahografit. Sot, kompanitë e mëdha të transportit me ndihmën e kompjuterëve dhe sistemeve telematike GPS mund të dinë në çdo kohë pozicionin e automjeteve të tyre, si dhe të gjithë parametrat e tjerë të automjetit dhe shoferit. Me avancimet e fundit të teknologjisë është zgjeruar rrethi i përdoruesve, domethënë, përveç pronarit të automjetit, përdorues janë bërë edhe shoferët, shfrytëzuesit e shërbimeve të transportit, organet e kontrollit të trafikut etj.

1.2 Rregulloret lidhur me tahografin

Është vërejtur se përdorimi i saktë i tahografëve, përveç ndihmës së madhe për pronarët e bizneseve transportuese në kontrollin e funksionimit të automjeteve, mund të shërbejë gjithashtu si një mjet efektiv për të rritur nivelin e sigurisë në trafik. Këto pajisje janë bërë me montim të detyrueshëm për kategori të caktuara të automjeteve.

Rregullorja për dimensionet, masat e përgjithshme dhe ngarkesat boshtore të automjeteve dhe kushtet themelore që duhet të plotësojnë pajisjet në automjetet e trafikut rrugor përcakton që pajisjen tahograf duhet të kenë autobusët, kamionët me peshë maksimale të lejueshme (pesha e automjetit + kapaciteti i automjetit) mbi 5 tonë, automjete speciale dhe të punës të afta për të zhvilluar shpejtësi më të madhe se 30 [km/h] dhe trolejbusët.

Shumë shpesh, dispozita e kësaj rregulloreje është keqinterpretuar se autobusët për trafikun urban dhe urbano-periferik nuk duhet të kenë një tahograf, gjë që është e pasaktë, domethënë këto automjete gjithashtu duhet të pajisen me to.

Sipas Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor nr. 05/L-088 (shkurtesa LRTRugor) [2], autobusi është një mjet motorik i destinuar për transportin e personave, të cilët përveç ulëses së shoferit, kanë më shumë se tetë ulëse. (Ky përkufizim ligjor jepet për arsye se disa automjete të prodhuara jashtë vendit, për shembull, me 10 ose më shumë ulëse nuk kanë tahografë të instaluar, por që të regjistrohen ose përdoren në vendin tonë, ato duhet patjetër ta instalojnë pajisjen e tahografit).

Rregullorja përcakton që tahografi duhet të tregojë dhe regjistrojë shpejtësinë e lëvizjes, kohën e udhëtimit dhe distancën e përshkuar nga automjeti përgjatë gjithë rrugës, të cilat janë funksionet minimale që duhet të ketë. Tahografët që kanë vetëm funksione minimale, d.m.th. nuk

mund të regjistrojnë aktivitete të tjera profesionale të shoferëve, përveç vozitjes, në praktikë quhen "të zakonshëm" (ato janë më të shumtë në automjetet tona) dhe mund të jenë njëditore dhe shtatë ditore (kështu që ata mund të regjistrojnë të dhënat për një dhe shtatë ditë në fletëzën “disk-diagramin” që vendoset në to). Mundësia për të regjistruar aktivitete të tjera profesionale të shoferëve që nuk i përkasin menaxhimit, kanë të ashtuquajturin tahografët "EURO", të cilët janë të detyrueshëm për automjete të caktuara në vendet e Bashkimit Evropian dhe mund të përdoren vetëm për një ditë.

Duke pasur parasysh këtë mungesë të tahografëve "të zakonshëm", drejtuesi i automjetit që posedon këtë tahograf duhet të ketë me vete një libër kontrolli individual, në të cilin është i detyruar të regjistrojë aktivitetet e tij.

Formulari i këtij libri dhe udhëzimet për plotësimin e saj jepen në Rregulloren për kohëzgjatjen totale të kohës së ngasjes, pushimet e shoferëve dhe mënyrën e punës së personelit të angazhuar në automjet, në masën që ndikon në sigurinë e ngasjes.

Drejtuesi i një automjeti me një tahograf "EURO" nuk ka pse ta ketë këtë libër. Fakti që policia rrugore po kërkon këtë libër nuk është e zakonshme, gjë që nuk do të thotë se ata nuk do të insistojnë në të në periudhën tjetër, me qëllim të përshpejtimit të zëvendësimit të tahografëve "të zakonshëm". Sipas rregulloreve metrologjike (rregulloret që përcaktojnë zonën e matjes), një tahograf është një njehsor (një mjet për matjen e parametrave të caktuar) për të cilët është i detyrueshëm një inspektim periodik me një periudhë jo më të gjatë se një vit (Fig 1.1).

Fig 1.1 Forma e një shënimi të tahgrafi të zakonshëm

Pas inspektimit, vulat dhe plombat (vula vjetore) vendosen në tahograf në vendet e duhura, në të cilat dy shifrat e fundit të vitit në të cilat vula është e vlefshme skadojnë në anën e djathtë. Meqenëse vula vjetore nuk lidhet me datën kur është kryer inspektimi, por me fundin e vitit kalendarik në të cilin skadon periudha e vlefshmërisë, inspektimet praktikisht kryhen brenda një periudhe jo më të shkurtër se një vit.

Për kompaninë e transportit, është më e lirë të kryhet ky inspektim në fillim të vitit (për shembull, nëse inspektimi kryhet më 1 janar 2022, tahografi vuloset me një afishe me numrin 01, d.m.th e vlefshme deri më 31.12.2022). Viteve të fundit në vendin tonë janë miratuar rregullore të reja metrologjike për tahografët, d.m.th. rregulla për kushtet metrologjike për pajisjet monitoruese për kontrollin e punës së shoferit dhe lëvizjen e automjeteve në trafikun rrugor (shkurtesa MUS) dhe udhëzimet metrologjike për inspektimin e pajisjeve të monitorimit për kontrollin e punës së shoferit dhe lëvizjen e automjeteve në trafikun rrugor (shkurtesa MUP). Çfarë ka të re në këto rregullore?

MUS shtrin numrin minimal të funksioneve të tahografit dhe e përcakton atë si më poshtë:

"Për qëllimet e këtij Rregulli, një tahograf nënkupton një njehsorë që tregon dhe regjistron:

1) distanca e përshkuar nga automjeti;
2) shpejtësia e automjetit;
3) koha e ngasjes efektive;
4) lloje të tjera të aktiviteteve të punës të personelit të automjetit;
5) pushimin ditor;
6) hapja e shtëpizës, pra heqja e disk-diagramit “fletësëz” së tahografit.

Duke pasur parasysh këtë zgjerim të numrit të të dhënave, janë vendosur afate në të cilat tahografët me një numër minimal të funksioneve duhet të zëvendësohen me të rinj.

Risia e parashikuar nga rregulloret e reja është detyrimi që verifikimi i tahografit nuk mund të kryhet në mënyrë të pavarur nga automjeti (vetëm në tavolinë siç është bërë deri më tani), por, përveç verifikimit në një pajisje të palëvizshme në laborator, verifikimi (ekzaminimi) duhet të kryhet edhe pas instalimit në automjet.

Kontrolli periodik kryhet nga laboratorë të akredituar sipas sdandartit SK EN ISO/IEC 17020:2018 [3] dhe vetëm ata subjekte të autorizuara nga Agjensia e Metrologjisë mund të lëshojnë certifikata të vlefshme të verifikimit të kryer, pra të vendosin vulën plombuese në tahograf dhe në senzorin e shpejtësisë. Për shkak të mospërputhjes me dispozitat e rregulloreve të lartpërmendura, janë përcaktuar edhe dispozitat penale, përmes te cilave sanksionohen shkeljet.

Kapitulli

2

2.NJOHURIT LIDHUR ME LEGJISLACIONIN DHE OBLIGIMET LIDHUR ME KOHËN E NGASJES DHE PUSHIMIT TË PERSONAVE NË TRANSPORTITN RRUGOR NDËRKOMBËTAR

2.1 Rregullore mbi tahografët dhe kufizimet e shpejtësisë nga aspekti i teknikëve në punim për tahografët

Ky kapitull ofron një pasqyrë të shkurtuar, sqarimet dhe komentet mbi dispozitat e rregulloreve të tahografit analog. Aspekti i aplikimit të aparatit të kontrollit-pajisjes së tahografit në parim rregullohet me Ligjin për Transportin Rrugor LTRr Nr. 04/L-179 [4] (shkurtesa LTRr) dhe Marrëveshjen Europiane "Për Punën E Ekuipazheve Të Mjeteve Të Përfshira Në Transportin Ndërkombëtar Rrugor (AETR) (shkuretsa AETR) [5]. Për sa i përket tahografit, LTRr Nr.04/L-179 [4] ka marrë përsipër të gjitha detyrimet ndërkombëtare që rrjedhin nga fakti se Kosova ka qenë një nga shtetet palë në marrëveshjen AETR (si pjesë ligjore e RSF Jugosllavisë) që nga viti 1974.Marrëveshja AETR trajton tahografin si pajisje për regjistrimin e aktiviteteve të drejtuesve (si anëtarë të ekuipazhit të automjeteve) në transportin ndërkombëtar dhe të gjitha kërkesat dhe kushtet teknike të nevojshme që mundësojnë përdorimin e tyre të duhur dhe kryerjen e funksionit të kontrollit. Përveç kësaj, Republika e Kosovës është në proces të harmonizimit të rregulloreve të saj me legjislacionin e Bashkimit Evropian, ku Rregullorja (BE) Nr. 165/2014 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian zbatohet në fushën e tahografit [6]. Rregulloret evropiane marrin përsipër kërkesat për gjeneratat dhe versionet e tahografëve dixhitalë (që më vonë iu bashkuan marrëveshjes AETR), por edhe për tahografët "smart" (të cilët nuk kanë hyrë ende në marrëveshjen AETR), gjë që lehtëson futjen e tyre në sistemin tonë ligjor [6]. Detyrimet në lidhje me përdorimin e tahografit si pajisje që instalohen në mjetet rrugore motorike janë të

përcaktuara në AETR [5]. Mirëpo, detyrimet në lidhje me mjetin në të cilin duhet të vendoset tahografi nuk janë në këtë ligj, por në rregulloren për ndarjen e mjeteve motorike dhe rimorkiove dhe kushtet teknike për automjetet në komunikacionin rrugor [7], që është akt nënligjor i Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor nr. 05/L-088 (shkurtesa LRrTRr) [2]. Më shumë informata për automjetet dhe rregulloret në lidhje me to mund të gjenden LTRr Nr. Nr. 04/L-179[4], ku parashihen detyrimet për përdorimin e tahografit për drejtuesit dhe transportuesit (pronarët ose përdoruesit e automjeteve) kur kryejnë transport mallrash me automjete me peshë maksimale të lejuar që tejkalon 3,5 ton ose gjatë kryerjes së transportit autobusë pasagjerësh (mjete pasagjerësh me më shumë se 8 ulëse përveç ulëses së shoferit).

Për më tepër, ai përcakton se cilat mjete transporti janë të përjashtuara nga detyrimi për të përdorur tahografin. Të gjitha përjashtimet bazohen në marrëveshjen AETR dhe rregulloret evropiane. Poashtu sqarimet shtese jepen edhe përmes udhëzimit administrativ nga Agjensioni i Metrologjisë së Kosovës-Ministria e Industrisë, Ndërrmarrësisë dhe Tregtisë për mënyrën e përdorimit të tahografit ajo përcakton se çfarë përbën përdorimin e duhur të tahografit analog në automjete dhe përcakton afatet për kryerjen e kontrollit të tyre (dmth verifikimin e tyre) [7].

Për sa i përket tahografit, ligji LRrTRr [2] përcakton detyrimet në lidhje me homologimin (miratimin e tipit) të tahografit dhe përbërësve të tij (njësitë e automjeteve, transmetuesit e impulsit, sensorët e lëvizjes, fletët e tahografit dhe fletëzat e tahografit) dhe mënyrën e instalimit të tij në automjete. Së bashku me aktet nënligjore të saj, Udhëzimi Administrativ 12/2020 për trupat Inspektuese të tahografit [8] dhe marrveshja AETR lidhur me përdorimin e tahografit, përcaktojnë detyrimet në lidhje me instalimin, rregullimin dhe inspektimin e tahografit analog (që korrespondojnë me kërkesat e marrëveshjes AETR), dhe së fundmi për tahografët “smart”, dispozitat përkatëse janë marrë nga Rregullorja (BE) 165/2014 [6] dhe aktet në zbatim të saj, si dhe lloji dhe mënyra e regjistrimit të tyre (dmth çfarë dhe si regjistrojnë). Kërkesat që lidhen me konceptimin, ndërtimin, lidhjen e komponentëve, sigurinë (parandalimi i manipulimit dhe abuzimit), konfigurimi (rregullimi), si dhe mënyra e regjistrimit të të dhënave dhe bartësit e të dhënave nuk janë subjekt i trajtimit në këtë temë diplome. Në këtë kapitull do të përshkruajmë dhe ilustrojmë obligimet lidhur me orët e ngasjes dhe pushimit të personave që marrin pjesë në procesin e transportit rrugor ndërkombëtar qoftë të udhëtarëve apo mallrave, mandej detyrimet, përmbajtjen, procedurat dhe mënyrën e kryerjes së aktiviteteve të mësipërme të këtyre aktiviteteve si dhe të dhënat që i shoqërojnë ato.

2.2 Orët e punës së personelit që i drejtojnë mjetet transportuese në kuadër të operatorit transportues

Produktiviteti në shfrytëzimin e automjeteve dhe autoparkut (ang. flotës) është një nga faktorët bazë në rritjen e konkurrencës dhe përmirësimin e pozicionit në treg. Mund të përcaktohet në disa mënyra. Në përgjithësi, produktiviteti i punës (W) në shfrytëzimin e automjeteve dhe mjeteve lëvizëse mund të paraqitet si raport i performancës së arritur (prodhimit) të mjeteve të flotës dhe punës së investuar të punëtorëve, të ashtuquajturat "puna e gjallë efektive", siç paraqitet në ekuacionin [9].

$$W = \frac{\text{Performanca e arritur e flotës}}{\text{Puna e investuar e punëtorëve}}$$

Kur është fjala për ecurinë efektive të flotës, mund të paraqitet në disa mënyra, p.sh. Me sasinë e transportit, punën transportuese, kilometrat e kaluara, kohën e angazhuar, etj. Puna e investuar, d.m.th., puna e drejtpërdrejtë mund të shprehet si numri i punëtorëve të angazhuar ose koha e angazhuar e punëtorëve në orë.

Ekzistojnë një numër i madh faktorësh të ndryshëm që ndikojnë në nivelin e angazhimit e punonjësve (administrimi, mirëmbajtja, marketingu). Megjithatë, një nivel i konsiderueshëm i punës së drejtpërdrejtë i referohet personelit të kompanisë, d.m.th. ekuipazheve të automjeteve. Përveç faktorëve organizativë të kompanisë, angazhimi i punës së gjallë efektive ndikohet ndjeshëm nga rregulloret dhe kufizimet që lidhen me ngasjen e kohës së automjetit gjatë orëve të punës ditore dhe javore. Këto kufizime janë një faktor i rëndësishëm dhe një përpjekje për të rritur sigurinë e trafikut dhe duke zvogëluar rrezikun për shoferët dhe mjedisin. Për më tepër, kufizimet dhe karakteristikat e kërkesave dhe detyrave të transportit ndikojnë në mënyrën e zotërimit të automjeteve dhe formimit të ekuipazheve.

2.2.1 **Legjislacioni dhe orari i punës së personelit (ekuipazheve) të automjeteve**

Kufizimet në kohën e punës të shoferëve të mjeteve në transportin rrugor përcaktohen nga rregulloret kombëtare, rregulloret e Bashkimit Evropian (BE) dhe marrëveshja AETR.

Marrëveshja AETR zbatohet për të gjitha udhëtimet e ngarkesave (mallrave) dhe pasagjerëve në transportin rrugor ndërkombëtar në territorin e shteteve nënshkruese. Rregulloret në Republikën e Kosovës, si dhe rregulloret e BE-së, në një masë të madhe janë të harmonizuara me rregulloret e marrëveshjes AETR. Këto rregullore rregullojnë orarin e punës së ekuipazhit të

mjetit, pushimet dhe pauzat e drejtuesit të mjetit, kohën e drejtimit të mjetit, kushtet që duhet të plotësojë tahografi[5], përdorimin e tahografit, posedimin dhe përdorimin e kartave të tahografit dhe automjetet në të cilin duhet të vendoset tahografi.

Më tej, rregulloret rregullojnë lëshimin e kartave të tahografit, kushtet dhe mënyrën e funksionimit të punishteve që kanë të bëjnë me tahografin, dhënien e lejeve për këto punishte, si dhe regjistrimet dhe mbikëqyrjen zyrtare. Këto masa dhe rregullore zbatohen për të rritur sigurinë rrugore, si dhe sigurinë dhe shëndetin në punë të anëtarëve të ekuipazhit të automjeteve.

Anëtar i ekuipazhit të mjetit mund të jetë shofer, bashkë-drejtues, person që e shoqëron shoferin në rrugë, por ai nuk është njëkohësisht shofer, konduktor, si dhe praktikant, d.m.th. një person që duhet të aftësohet për punë të pavarur në profesion. Nëse ekuipazhi i mjetit ka të paktën dy drejtues të cilët mund ta drejtojnë mjetin, gjatë çdo periudhe drejtimi, ndërmjet dy pushimeve të njëpasnjëshme ditore ose ndërmjet pushimit ditor dhe javor, atëherë ai është një ekuipazh shumë anëtarësh [5].

Vendi i punës së një anëtari të ekuipazhit të mjetit është vendi ku kryhet veprimtaria kryesore e transportuesit që punësoi anëtarin e ekuipazhit të automjetit, ose vendndodhje të tjera të transportuesit, pavarësisht nëse ato janë në të njëjtin vend me vendndodhjen e transportuesit ku kryhet veprimtaria kryesore. Gjithashtu, vendi i punës së anëtarit të ekuipazhit të mjetit është mjeti në të cilin ndodhet anëtari i ekuipazhit kur është në detyrë, si dhe vende të tjera ku kryhen punët e lidhura me transportin e vazhdueshëm [5].

Koha e disponueshmërisë nuk konsiderohet kohë pune. Kjo kohë përfshin periudha kohore gjatë të cilave anëtari i ekuipazhit është gati të fillojë ose të vazhdojë drejtimin ose të kryejë detyra të tjera, por nuk është në vendin e tij të punës. Koha e disponueshmërisë përfshin pritjen në kufi, pritjen me kërkesë të organit të kontrollit, kohën kur një anëtar i ekuipazhit të mjetit shoqëron mjetin e transportuar me traget ose tren, si dhe kohën gjatë ndalimit të automjeteve. Në rastin e shumë antarëve të ekuipazhit, koha e disponueshmërisë është koha që shoferi kalon pa drejtuar mjetin dhe është në një vend ose shtrat në kabinën e një automjeti në lëvizje [5].

Koha e punës është periudha nga fillimi deri në përfundim të punës, gjatë së cilës një anëtar i ekuipazhit të mjetit ndodhet në vendin e tij të punës, në dispozicion të punëdhënësit dhe kryen detyrat e tij, duke përfshirë çdo punë për transportuesin ose punëdhënësin tjetër [5].

Orari i punës së shoferit dhe ekuipazhit përfshin kohën nga fillimi deri në fund të punës, gjatë së cilës shoferi dhe anëtarët e ekuipazhit janë në vendin e tyre të punës, në dispozicion të

punëdhënësit dhe kryejnë detyrat dhe aktivitetet e tyre në : ngasje, ngarkim dhe shkarkimin e pasagjerëve, mirëmbajtjen e automjeteve, sigurimin e automjeteve, ngarkesave dhe pasagjerëve, si dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera ligjore që lidhen me procesin e transportit. Me fjalë të tjera, kjo kohë përfshin, përveç kohës së drejtimit të mjetit, kohë tjetër për realizimin e detyrave të tjera në kuadër të transportit rrugor. Këtu duhet bërë një dallim ndërmjet orëve mesatare dhe më të gjata javore të punës, orëve më të gjata ditore të punës dhe punës së natës të një anëtari të ekuipazhit të automjetit. Kështu, koha mesatare javore e punës së një anëtari të ekuipazhit të automjetit për çdo katër muaj kalendarik të njëpasnjëshëm nuk mund të kalojë 48 orë, duke përfshirë punën jashtë orarit. Koha maksimale javore e punës së një anëtari të ekuipazhit të automjetit mund të jetë 60 orë, duke përfshirë punën jashtë orarit. Për më tepër, orët më të gjata ditore të punës së një anëtari të ekuipazhit, duke përfshirë punën jashtë orarit, nuk mund të jenë më të gjata se 14 orë në një periudhë 24-orëshe. Së fundi, nëse një anëtar i ekuipazhit të automjetit kryen punë natën, orari i punës nuk duhet të jetë më i gjatë se 10 orë gjatë një periudhe 24-orëshe [5].

Nga pikëpamja e organizimit të transportit rrugor, është e dobishme të theksohet se është e nevojshme të regjistrohet saktë dhe në mënyrë adekuate koha e vozitjes që nuk bie në fushëveprimin e rregulloreve ligjore, koha e disponueshmërisë, si dhe të regjistrohen punët e tjera të përcaktuara në orët e tjera të punës, pushimet dhe pauzat. Këto të dhëna futen manualisht në anën e pasme të fletëve të tahografit për tahografin analog ose letrën termike për tahografin dixhital. Koha e vozitjes që nuk hyn në fushën e zbatimit të rregulloreve ligjore regjistrohet si orë të tjera të punës. Operatori transportues i cili merret me transportin e mallrave dhe/ose pasagjerëve është e detyruar të mbajë shënime për orarin e punës të të gjithë anëtarëve të saj të ekuipazhit të automjetit.

Koha e drejtimit (vozitjes) së mjetit është vetëm një nga elementet e kohës së punës së shoferit, dmth. ekuipazhit të automjeteve. Meqenëse kjo kohë është shumë e rëndësishme nga pikëpamja e sigurisë në komunikacion, parashikohen kufizime në kohëzgjatjen e saj. Kufizimet në kohën e vozitjes mund të vërehen në lidhje me:

- koha e vazhdueshme e vozitjes,
- koha e vozitjes gjatë ditës,
- koha e vozitjes gjatë javës.

